



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

C-IV-13-3116

Parashtruesi i kërkesës

A K

Kundër

Pala kundërshtare

Agjencia Kosovare e Privatizimit- (AKP) (NSH “P-M” në Likuidim), Rr, “Agim Ramadani”, nr. 23, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), sipas gjyqtarit Gazmend Sylaj, me 14 shtator 2021, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- I. Ankesa e ankuesit refuzohet si e pabazuar.**
- II. VËRTETOHET vendimi i Autoritetit të Likuidimit PRZ042-0119 datë 14 tetor 2013.**
- III. Nuk caktohen shpenzime gjyqësore.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 18 nëntor 2013, ankuesi parashtror në DHPGJS, një kërkesë, të emërtuar ankesë, për rishqyrtimin e Vendimit PRZ042-0119 datë 14 tetor 2013 (tani e tutje VENDIMI), lëshuar nga ana e Autoritetit të Likuidimit të AKP (tani e tutje: AL), me anë të të cilit kërkesa për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, në shumë të pacaktuar, ndaj NSH “P - M”, i është refuzuar.

Sipas vendimit të AL, arsyeja e refuzimit është sepse ankuesi duke filluar nga data 6 shkurt 2006 ishte i pensionuar.

Ankuesi, me ankesën e tij, fillimisht pohon se duke filluar data 7 mars 2001 ka inicuar kontest nga marrëdhënia e punës, kundër NSH, e cila pas disa procedurave të zhvilluara pranë Gjykatës Komunale në Prizren (GJKP) sipas lëndës C.nr. 381/07, për shkak të inkompetencës lëndore të Gjykatës Komunale, në vitin 2012 lënda referohet pranë DHPGJS.

Ankuesi tutje me ankesë, përshkruar gjendjen se si i është ndërprerë marrëdhënia e punës pranë NSH, nga siç ceket, një grup personash – punëtorësh të NSH përfshirë edhe drejtorin e NSH.

Ankuesi po ashtu procedurës së kontestit nga marrëdhënia e punës i referohet lëndës e cila pranë DHPGJS evidentohet sipas lëndës C-III-12-0254.

Kërkesës për rishqyrtim i janë bashkangjitur:

- Kopja e Vendimit të AL,
- Kopja e Aneks Kontratës, e lidhur me 18 gusht 1999, mbi mes NSH dhe D “A”,
- Kopja e shkresës nr. 297 datë 25 nëntor 1999,
- Kopja e një procesverbali, me dorëshkrim të lirë, datë 25 nëntor 1999,
- Kopja e gazetës zyrtare të RS nr. 79/991,
- Kopjet e procesverbaleve, me dorëshkrim të lirë, datë 7 nëntor 2000 dhe 16 nëntor 2000,
- Kopje e Vendimit, lëshuar me 5 maj 2000,
- Kopja e kërkesës mbi informata shtesë drejtuar ankuesit nga ana e AKP, datës 3 shtator 2009,
- Kopja e një shënimi, i palexueshëm dhe i shkruar me dorëshkrim të lirë,
- Kopja e Vendimeve, nr. 60 datë 30 korrik 1999 dhe 33/02 datë 17 shtator 1999,
- Kopja e Vendimit nga Fondi pensional dhe invalidor, nr. 7017239593, dhe
- Kopje të Aktgjykimit të GJKP, C.nr. 108/01 datë 15 maj 2002, me të cilin padia e paditësit A K kundër NSH është aprovuar dhe NSH është obliguar që paditësin ta kthej në punë dhe detyra të punës së referentit komercial, me gjysmë të orarit të punës gjersa padia mbi kompensimin e pagave është konsideruar e tërhequr nga paditësi (në tekstin e mëtutjeshëm AKTGJYKIMI i GJKP).

Me 4 qershor 2014, gjykata lëshoj një urdhër për ankuesin me të cilin ju kërkua që të parashtrij kopjen e autorizimit për përfaqësuesin e tij ligjor i cili duhet të jetë anëtar i Odës së Avokatëve.

Duke vepruar sipas urdhrit, të cekur si më lartë, me 30 qershor 2014, u parashtrua kopja e autorizimit për av A K.

Bazuar në urdhrin e gjykatës, AKP me 12 shtator 2014 parashtrij përgjigjen.

AKP kundërshtoj ankesën si të pabazuar. AKP konsideron se ankesa nuk përmban argumentet ligjore mbi të cilat do të mbështetej ankesa ashtu siç parashihet sipas dispozitave ligjore të Ligjit për DHPGJS. Tutje AKP pohon se ankuesi, nuk i është ndërprerë marrëdhënia e punës me veprimin e AKP. Në përgjigje tutje theksohet se ankuesi me Vendimin e Ministrisë së punës dhe mirëqenies sociale, datë 12 prill 2006 i është aprovuar e drejta në pension duke filluar nga 6 shkurt 2006, gjersa në anë tjetër NSH është privatizuar me 12 qershor 2007. Nga gjitha arsyet, AKP, thekson se ankuesi nuk i ka plotësuar kushtin ligjor të paraparë sipas nenit 40 paragrafi 1.6.2 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 për AKP (Shtojca e Ligjit për AKP), e që ti njihej e drejta në dëmshpërblim për shkak të shkëputjes së kontratës së punës. AKP përfundimisht propozoj që kërkesa për rishikim të hedhet si e papranueshme ose refuzohet si e pabazuar dhe Vendimi i AL të vërtetohet.

Përgjigjes i është bashkangjitur:

- Kopja e Vendimit të AKP mbi fillimin e procedurës së likuidimit të NSH.

Duke vepruar sipas urdhrit të gjykatës, përfaqësuesi i ankuesit me 17 tetor 2014 parashtrij përgjigjen.

Me përgjigje kundërshtohet përgjigja e AKP si dhe kundërshtohet arsyetimi sa i përket interpretimit të nenit 40 paragrafi 1.6.2 të Shtojcës së Ligjit për AKP. Me përgjigje, tutje pohohet se duke filluar nga 12 qershori 2007, fillimisht pranë GJKP e tani pranë DHPGJS

(sipas lëndës C-III-12-0254), zhvillohet procedura gjyqësore – kontest pune ndaj NSH. Nga gjitha arsyet kërkohet nga gjykata që arsyet e dhëna në përgjigjen e AKP/s të konsiderohen si të pabazuara.

Përgjigjes i janë bashkangjitur:

- Kopja e AKTGJYKIMIT të GJKP,
- Kopja e Aktvendimit të GJKP nr. 381/07 datë 30 janar 2012, me të cilën GJKP shpallet jokompetente dhe lënda referohet pranë DHPGJS,
- Kopjet e shkresave të lëndës C-III-12-0254.

Bazuar në urdhrin e gjykatës, AKP me 20 nëntor 2014 parashtroj kundërpërgjigje.

AKP, kundërshtoj pohimet e ankuesit në përgjigje dhe mbeti në tërësi si pranë përgjigjes.

Me 19 qershor 2020, gjykata pranoi një parashtresë nga përfaqësuesi i paditësit, avokat Agim Kabashi, me të cilën informoj gjykatën se nuk do të jetë më përfaqësuesi i tij.

Gjykata, bazuar në pohimet e ankuesit, referuar lëndës C-III-12-0254, në bazë të shënimeve të zyrës së regjistrimit procedura sipas kësaj lënde është zhvillim e sipër.

Arsyvetimi ligjor:

Kërkesa për rishqyrtim të Vendimit të AL refuzohet si e pabazuar.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit për DHPGJS (ligji nr.06/L-086) në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe merr Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Nga Vendimi i AL, shihet se ankuesi duke filluar nga data 6 shkurt 2006, është e pensionuar. Këtë fakt nuk e mohon as ankuesi.

Privatizimi i NSH ka përfunduar me 12 qershor 2007, çka do të thotë se ankuesi në momentin e privatizimit respektivisht likuidimit, nuk ishte punëtor i NSH dhe njëherit nuk gëzonte të drejtën në të ardhura personale.

Referenca e ankuesit, lidhur me kontestin e punës e cila pranë DHPGJS zhvillohet si lënda C-III-12-0254, i përket një çështjeje tjetër. Në lëndën konkrete ankuesi ka kërkuar anulimin e Vendimit të NSH, nr. 552 datë 3 janar 2001, mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës dhe të drejtat e tij respektivisht detyrimet e NSH të cilat rrjedhin nga si rezultat i ndërprerjes së marrëdhënies së punës.

Në rastin konkret bazuar sipas nenit 31 paragrafi 4 dhe 5 dhe nenit 35 paragrafi 2.4 të Ligjit për DHPGJS është obligim i palës, në këtë rast ankuesit, që në parashtresat e tij me shkrim, ankesën, të paraqesë një pasqyrë të hollësishme të fakteve dhe arsyetimit ligjor mbi të cilin vendos qëndrimin dhe argumentimin e tij. Në rastin kur pala pohon, në këtë rast ankuesi, të ekzistojë një fakt, ajo palë është e obliguar të paraqesë prova, fizike dhe/ose dëshmuar, për mbështetjen e atij pohimi.

Nga dispozita e lartë cekur, është obligimi i ankuesit që të dëshmoj se atij do ti takonte e drejta në kompensim për shkak të shpërndarjes së parakohshme të kontratës së punës. Në rastin konkret ankuesi nuk ka dëshmuar se AKP i ja ka ndërprerë kontratën e punës.

Lidhur me kompensimin, si rezultat i shitjes apo privatizimit apo edhe likuidimit nga ana e AKP, duke u bazuar në nenin 40 të SHTOJCËS së Ligjit për AKP mbi prioritet e kërkesave dhe interesave, paragrafi 1.6 pika 1.6.2 parashihet e drejta në kërkesa për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës të sjella nga punonjësit të cilat janë pushuar nga puna si rrjedhojë e Vendimit për Likuidim të ndërmarrjes, apo në lidhje me veprimin e ndërmarrë nga Agjencia sipas nenit 6.1 apo 6.2 të Ligjit për AKP-në .

Nga dispozitat e lartëcekura, mund të konkludohet se, punëtori/ja gëzon të drejtën në paga respektivisht dëmshpërblim nëse:

- a. Kontrata mbi punën i është ndërprerë para afatit të përfundimit, të saj;
- b. Pushimi nga puna ka ardhur si pasojë i Vendimit të AL, dhe
- c. Ndonjë veprim nga Agjencia, lidhur me administrimin e ndërmarrjes, shitjes, likuidimit etj.

Ankuesi, nga gjitha arsyet të cekura si më lartë, nuk ka dëshmuar të drejtën e tij ashtu siç edhe parashihet sipas nenit 40 të SHTOJCËS së Ligjit për AKP, paragrafi 1.6 1.6.2 por edhe nuk ka dëshmuar ndonjë obligim tjetër ashtu siç parashihet sipas nenit 31 paragrafi 4 dhe 5 dhe nenit 35 paragrafi 2.4 të Ligjit për DHPGJS

Nga gjitha arsyet u vendos si në dispozitiv.

Taksat gjyqësore

Kërkesa kreditore e ankuesit është në shumë të paspecifikuar.

Në pajtim me nenin 62 të Ligjit për DHPGJS palët i bartin vetë shpenzimet gjyqësore.

Andaj edhe u vendos si në dispozitiv.

Këshilla juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrahet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të DHPGJS brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për DHPGJS.

Gazmend Sylaj, Gjyqtar